

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
« SABATEL » SH.P.K.



Ne Vlore sot ne daten 09.03.2006 ne qendren e shoqerise «SABATEL » sh.p.k., ne oren 18 :30 fillon mbledhja e asamblese se ortakeve te shoqerise, me rend dite :

1. Miratimi i raportit te ekspertit kontabel per pasqyrimin e rritjes se kapitalit te shoqerise
2. Te ndryshme dhe eventuale

Ne mbledhjen e asamblese, ku jane te pranishem ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise dhe eksperti i kontabel i caktuar prej tyre per te raportuar mbi rritjen faktike te kapitalit te shoqerise, u diskutua gjate raporti i ekspertit kontabel z. Namik Veipi.

Pas nje analize dhe shqyrtimi te hollesishem e ze per ze te bilancit te vitit 2004, ortaket e asamblese me unanimitet vendosen te miratojne raportin e ekspertit dhe te konstatojne rritjen e kapitalit te shoqerise nga 100.000 leke ne 21.422.450 (njetete e nje milione e katerqind e njetete e dy mije e katerqind e pesedhjete) leke; duke patur keshtu nje rritje kapitali me *21.322.450 (njetet e nje milione treqind e njetet e dymije katerqind e pesedhjete) leke.*

Pas miratimit te kesaj pike, ortaket vendosen t'i drejtohen Gjykates se Tiranes per te pasqyruar ndryshimet ne Regjistrin Tregtar.


ORTAKET E SHOQERISE

Isaev Abdullo

Sali Salis

Abdullë Ismaili

Vlore, me nente ,mars dymije e gjashte



RAPORT PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR
TË SHOQËRISË " SABATEL " sh.p.k

Unë, I nënshkruari **Namik VEIPI**, ekspert kontabël I autorizuar, anëtar I Institutit të IEKA, me Nr. 60, me vendimin e Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, Nr. 24.262/2 jam caktuar ekspert kontabël I shoqërisë "Sabatel" sh.p.k, të kryej ekspertimin e vlerësimit të rritjes së kapitalit të shoqërisë, e cila e ka qendrën në Babica e Madhe Vlorë,.

Për kryerjen e këtij misjoni jam mbështetur në dokumentacionin e mëposhtëm :

- Ligji Nr. 7638 dt. 19/11/1992 "Për shoqëritë Tregëtare".
- Vendimi I Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë .
- Statuti dhe akti I themelimit të shoqërisë "Sabatel" sh.p.k.
- Bilanci I vitit 2004 (deri 31/12/2004).

I caktuar, me cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, përtë kryer vlerësimin e rritjes së kapitalit, të shoqërisë " Sabatel " sh.p.k, nga 100.000 lekë, I cili është tërësisht kapital financiar dhe I depozituar në bankë në emër të saj .

Kapitali themeltar është I ndarë në tre pjesë , sipas vendimit nr. 24.262/1, si më poshtë :

1. Sali Saliu 33.4%
2. Izër Avdullai 33.3%
3. Avdul Yzeiri 33.3%

Sipas statutit të shoqërisë, neni 8, ortakët kanë të drejtë, nëpërmjet vendimeve të Asamblesë se Zakonshme, të bëjnë zmadhimin e kapitalit nëpërmjetpërfshirjes së fitimeve e të rezervave.

Në kapitalet e veta, të shoqërisë, sipas bilancit të vitit 2004, vlera prej 21.422.450 lekë përfaqëson kapitale të veta të shoqërisë të cilat përbëhen nga:

- Kapitali I nënshkruar	lekë	18.327.284
- Rezervat statutore	"	127.698
- Fitime të mbartura	"	2.012.765



- Fitimet e ushtrimit " 954.703

Nga verifikimet e kryera rezulton se këto poste janë krijuar sipas ligjit dhe I përkasin shoqërisë " Sabatel " sh.p.k .

Zmadhimi I kapitalit të shoqërisë është realizuar, sipas vendimit unanim të ortakëve, nëpërmjet kalimit të fitimeve, të realizuara sipas bilancit të mbyllur dt. 31/12/2004, në fitime për rritjen e kapitalit, në rezerva statutuore sipas nenit 11 të Statutit.

Pra : në total kapitalet e veta të shoqërisë bëhen 21.422.450 lekë, nga 100.000 lekë që ishte në fillim të aktivitetit të shoqërisë, sipas vendimit nr. 24.262 dt. 18/8/2000, me një rritje prej 21.322.450 lekë, I përbërë nga rezervat statutuore 127.698 lekë dhe fitimi I realizuar 21.194.752 lekë.

Duke patur parasysh se : unë kam përmbushur misjonin tim, bazuar në vlerat e bilancit të dt. 31/12/2004, vërtetoj se llogaritë kontabile të kësaj shoqërie, për efekt të vlerësimit të tyre për zmadhimin e kapitalit, shprehin vlerën pasurore reale të shoqërisë, që përfaqësohet nëpërmjet kapitalit themeltar për vlerën 21.422.450 lekë.

Si konkluzion : kapitali themeltar I nënshkruar I shoqërisë në fillim të aktivitetit të saj e deri dt. 31/12/2004 është 100.000 lekë dhe, me vlerësimet sipas këtij akti, bazuar në Legjislacionin përkatës, bëhet 21.422.450 lekë, me një rritje prej 21.322.450 lekë, sëbashku me rezervat.

Pjesmarrja në kapitalin e shoqërisë

Pas zmadhimit të kapitalit, të shoqërisë, pjesmarrja në kapital rezulton si vijon :

1. Sali Saliu zotëron 33.4% të kapitalit;
2. Izdër Avdullai zotëron 33.3% të kapitalit;
3. Avdul Yzeiri zotëron 33.3% të kapitalit.

Rekomandoj se me ndryshimet e kapitalit të bëhen ndryshimet dhe në statutin e shoqërisë.

Adresa : Lagje " 4 Herojte " Rruga " 4 Herojte " Nr. 33 Vlorë
Tel : 035503322889
Cel:0692063124, Cel: 0692113146

NAMIK VEIPI
ESPERT KONTABEL
VLORE
MINISTRIE E TREGETISE DHE
VLCRA
PAMV
TEL. 00422889



Bashkangjitur këtij raporti është dhe pasqyra, për përcaktimin e vlerës së zmadhimit të kapitalit.

Vlorë, më _____ 2005

**EKSPERTI KONTABËL AUTORIZUAR
NAMIK VEIPI**

NAMIK VEIPI
EKSPERT KONTABËL
LIQ. NO. NR. 60
MINISTRI E F. P. S. E
VLORE - Z. C. E.
PAMVARSHIA
TEL. 068121111

**SHOQËRIA
" SABATEL " SH.P.K
VLORE**

KAPITALET E VETA

Nr	P a s I v i	njësia	para zmadhimt kapitalit	pas zmadhimt kapitalit
1	Kapitalet e veta	lekë	21.422.450	21.422.450
a	Kapitali I nënshkruar	"	18.327.284	21.294.752
b	Rezervat	"	127.698	127.698
c	Fitime të mbartura	"	2.012.765	-
d	Fitime të ushtrimit	"	954.703	-

V.O Totali I kapitaleve të veta është 21.422.450 lekë ose 100% e ndarë sipas aksionerëve :

1. Sali Saliu 33.4%
2. Izdër Avdullai 33.3%
3. Avdul Yzeiri 33.3%

068121111